

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin Ca' Foscari në Venecia, Itali, për vitin akademik 2021-2022.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Ca' Foscari të Venecias në Itali, në kuadër të programit Erasmus +, për stafin akademik me kohë të plotë të UT-së për mësimdhënie, për vitin akademik 2021-2022.

<https://www.unive.it/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

Fushat:

- Histori dhe Arkeologji;

Katalogu i kurseve:

<https://www.unive.it/data/9639/>

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik (5 + 2 ditë);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin (160 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze / italiane sipas formatit Europass);

- Formulari i aplikimit, sipas linkut:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/2_Incoming-Erasmus_APPLICATION-FORM-1.docx

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze / italiane);

- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze / italiane (niveli B2);

- Plan pune në gjuhën angleze / italiane;

- Vërtetim punësimi në gjuhën Shqipe dhe të përkthyer në gjuhën angleze / italiane;

- Letër suporti nga një pedagog në Universitetin Ca'Foscari (mund të kontaktoni tek: international.cooperation@unive.it duke dërguar CV dhe planin e punës);

- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo një bursë shkëmbimi Erasmus+ (nëse po, ku);

- Plani i mobilitetit, sipas linkut:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/3.3_Template_Mobility-Agreement_STAFF-for-teaching.doc

Afati për aplikim: 01 Tetor 2021

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!